



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-26-1059-1-3-6/C926



K O N T R A T Ë /FURNIZIM

Emri i Projektit: **Furnizim dhe blerja e rrobave te punes per zyre te DSHPE-së dhe puntoret e njesis se zjarrfikseve dhe shpetimit-Drenas**

Numri identifikues: : **611-26-1059-1-3-6** ,27.04.2026; Nr. i arkivit; **02-400/01-14969**

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT , përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit (më tutje “Punëdhënës”).

" Sankos " Sh.p.k., rr."Vëllezerit Çaka"pn, Kaçanik përfaqësuar nga **XHAVIT NEZIRAJ**, Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Furnizim dhe blerja e rrobave te punes per zyre te DSHPE-së dhe puntoret e njesis se zjarrfikseve dhe shpetimit-Drenas**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të **furnizimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹.
Periudha e kryjes se punëve/shërbimeve dhe **furnizimeve** do të jetë deri në afatin : **20 dite**

3 Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **4,946.10 €**; [**Katerë mijë e Nentëqindë e Katerëdhjetë e Gjashtë euro**]

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë

se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Kryetari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së **furnizimeve** duhet të jetë brenda **10 dite**. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen D.SH-P.E-se.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **furnizimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **furnizimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve**/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, dhe në pajtım me Menaxherin e caktuar nga Kryetari i Komunes.

Neni 7 Garancioni i shërbimeve]

7.1 Garancioni aplikohet sipas pershkrimeve ne paramas .

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas

kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.


Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **menjehere pas nënshkrimit.**


Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GENTIANA QELA	Emri:	XHAVIT NEZIRAJ
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	27.04.2026	Data:	27.04.2026
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA SE BASHKU ME SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR UNIFORMA TË ZYRTARVE TË DSHPE-së dhe UNIFORMA TË PUNËS PËR ZJARRËFIKËS

PARAMASA DHE PARALLOGARIA SE BASHKU ME SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR UNIFORMA TË ZYRTARVE TË DSHPE-së		Njësia	sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Rroba komplecte/M/F Komplet i rrobave për Meshkuj dhe Femra • Materiali 65% polyester/ 35% pambuk • Ngjyra e preferuar e kaltërt e mbyllët(M) / e kalter me e lehtë (F),ose mundet te zgjidhet edhe nga vete pranuesi i rrobeve	4 koml për M dhe 4 komp F	8	170.00	1,360.00
2	Këmisha Këmisha me mang të gjata Pjesa e jashtme: 65% poliester 35% pambuk 135-140 gr/m ² me trajtim për mbrojtje nga njollat	4 copë për M dhe 4 copë F	8	30.00	240.00
3	Këpuçë Këpuçë me lidhëse, nivel të ulët, me sistem klimë frymëmarrës, të rezistueshme ose të papërshkueshme nga uji, metarial i lekurës, me ngjyrë e zezë. Këpuçët, garancion dy vite	Këpuçët 4 pal për M, dhe 1 palë për F	8	50.00	400.00
Rikapitullim pvr rroba të DSHPE-së					
Komplet i rrobave për Meshkuj dhe Femra					1,360.00
Këmisha me mang të gjata					240.00
Këpuçët					400.00
Total					2,000.00

PARAMASA DHE PARALLOGARIA SE BASHKU ME SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR UNIFORMA TË PUNES PËR ZJARRFIKËS	Njësia	sasia	Çmimi	Çmimi total
<p style="text-align: center;">XHAKETË TAKTIKE VERORE</p> <p>Xhaketa verore duhet te jete e dizajnuar për të siguruar mbrojtje të mofit me shi, e lehtë dhe efektivy për patrullimi, xhaketa duhet te jete shume e lehtë, e mbyllur me shtresa, rezistuese nga era dhe uji, ndërsa ofron një ajrosje shume te mire.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Materiali 100% poliester (soft shell) • Duhet te kete material elastik (stretch softshell) • Duhet te jete rezistente ndaj ujit dhe eres • Mbyllje për shtrëngimin e mëngëve • Zinxhir deri ne fund te jakës • Duhet të ketë xhepa me zinxhirë • Të ketë 3 xhepa te brendshëm • Të ketë 2 xhepa për ID – Panel ne kraharor • Të ketë 1 xhep te madhe për ID – Panel ne shpinë • Të këtë zinxhir origjinal • Ngjyra: E zeze • Madhësitë: XS-XXL <p>Materiali Materiali 100% poliester (soft shell) rezistuese nga era dhe uji, materiali i mbyllur me shtresë te laminuar, e izoluar me trake izoluese ne te gjitha vendet ku ka qepje, mundëson ajrosjen sa me te mire.</p> <p>Funksionet Xhaketa e verës duhet te jete e qëndrueshme kundër ujit dhe erës materiali poliester. Zinxhiri duhet te jete origjinal te ketë kapësen me një lidhëse shtese Pjesa e pasme duhet te jete me e gjate se pjesa para Zinxhir origjinal për te gjitha mbylljet me zinxhir Qepja dhe ngjitja Komplet materiali i qepur ne mënyrë speciale për bllokimin e ujit dhe shiut me qepje me një gjilpërë për ndalje te ajrit dhe ujit. Xhaketa duhet te ketë qepje te forta ne pjesët me stres te madh.</p> <p>Mbylljet Zinxhir origjinale Etiketat Etiketa me Përbajtje/Kompaninë, etiketën me numrin e artikullit, etiketa ne vendin ku varet Xhaketa, dhe etiketa kryesore te detajuar. Sjellja e mostrës obligative</p>	copë	17	49.00	833.00

Pantallona taktik					
2	<p>Pantallona taktik duhet të jenë të qëndrueshme, profesionale në dukje, të kenë je</p> <p>Specifikacionet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshatje superfore • Pjesa e belit e vetë përshatshme (elastike) • Zinxhirë origjinal YYK dhe butona PRYM • Të trajtuara me Teflon për rezistente ndaj njollave, ujit dhe baltes • Xhepa kargo me sistem të integruar të varjes së gjësëndeve brenda • Materiali: Poliester elastik mekanik 65% Poliester dhe 35% pambuk • Dy xhepa të jashtëm anësorë • Material Ripstop 190 gr/m2. • Ngjyra e zeze <p>Materiali</p> <p>Pjesa kryesore: Poliester elastik mekanik 65% Poliester, 35% pambuk; rezistente ndaj grisjes Ripstop; të trajtuara me Teflon për rezistence ndaj ujit. Gjeprat: 80% Poliester 20% Pambuk, te qepura shume fort.</p> <p>Qepja duhet të jetë e fortë me 10 shipime për 2.5 cm me penjë shumë të fortë me 5 fije.</p> <p>Funksionaliteti</p> <p>Duhet të jenë të punuara nga materiali i fortë poliester/pambuk Ripstop, pantallonat duhet të jenë të përshatshme për kushte të vështira dhe për operacione speciale. Duhet të jenë të qëndrueshme për komfort superior, funksionalitet dhe përshatje të madhe, pantallonat duhet të kenë shtrengim në bel të vetë përshatshme për lehtësinë gjatë përkuljes dhe zgjatjes.</p> <p>Xhepat</p> <p>Xhepat e përparmë të pantallonave duhet të jenë të fortë dhe të mëdhenj, xhepat te mëdhenj anësorë. Pantallonat duhet të kenë edhe dy xhepa të pasmë për mundësin e mbajtjes së gjësëndeve për çfarëdo operacioni të punës.</p> <p>Skajet e xhepave të përparmë duhet të jenë të përforcuar me najlon kordura që të mundësojnë varjen e aksesorëve në xhep dhe qëndrueshmërinë e xhepave.</p> <p>Xhepa për vendosjen e telefonit afër xhepave te përparmë.</p> <p>Xhepat e brendshëm brenda xhepave duhet të jenë të punuar nga materiali poliester/pambuk i fortë dhe duhet të jenë shumë të thellë.</p> <p>Xhepat e brendshëm duhet të jenë pa mbyllës për përdorim të lehtë dhe duhet të jenë të qepur me qepje të dyfishtë për qëndrueshmëri.</p> <p>Xhepat anësorë duhet të kenë mbyllëse që palohet dhe të kenë mundësi të mbylljes edhe kur ata janë të mbyshur komplet. Xhepat e brendshëm të ndarë duhet të kenë funksion të dyfishtë; gjësëndet e vogla duhet të hynë brenda dhe disa aksesorë me kapëse duhet të kenë mundësi të kapen në faqen e xhepave. Palimi i xhepave anësorë duhet të jetë në mënyrë që gjësëndet që gjinden brenda të mos dallohen.</p> <p>Xhepat mbrapa duhet të kenë qepje që nuk duken dhe të jenë dyfish të qepur. Xhepat mbrapa duhet të jenë me mbyllës me velkro.</p> <p>Qëndrueshmëria</p> <p>Pantallonat duhet të jenë të punuara nga materiali poliester elastik mekanik (Flex-Tac fabric) 65% poliester/35% pambuk ripstop (me bllokues të grisjes) që rezistojnë ndaj grisjes dhe abrazionit. Pantallonat duhet të jenë me qepje të trefishtë në të gjitha vendet me stres të madh.</p> <p>Zinxhiri dhe Butonat</p> <p>Vetëm zinxhirë origjinal YYK dhe butona kualitativ PRYM duhet të përdoren në mënyrë që zinxhiri të jetë i fortë dhe butonat të rrinë të mbyllura edhe në aktivtete shumë të vështira.</p> <p>Garancioni 1 vit</p> <p>Sjellja e mostrës obligative</p>		17	39.00	663.00

Këpucët					
3	Këpçë të ndertuara për kushte të veshitira pune në teren , lekur e plotë Gomë që ofron mbrojtje maksimale, e fortë dhe e rehatshme, rezistente deri në 250 OC ,si dhe rezistente ndaj rrëshqitjeve Këpçët duhet të jenë sipas standardeve : EN ISO 20345:2011 S3				
4		copë	17	50.00	850.00
5	Maica Pollo Maica me mangë të shkurtra me jaka si dhe me nga tri pulla nga materiali i Pambukut Ngjyrë e kalter e mbylltë .	copë	34	17.65	600.1

Rikapitulim përgjithshëm për rroba për zyrtar të DSHPE-së dhe Zjarrfikës	
Furizimi me Uniforma të zyrtarve të DSHPE-së	2,000.00
Xhaketa taktike verore	833.00
Pantallona taktik	663.00
Këpucët	850.00
Maica Pollo	600.10
Total	4,946.10

Eperatori Ekonomik që i plotëson kriteret duhet që të sjell mostren e rrobeve në mënyrë Obligative tek komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të ofertave, në mënyrë që të vertetohet cilësia e rrobeve.

Plani Dinamik : 25 ditë nga dita e nënshkrimit të Kontratës dhe Planit të menaxhimit

Afrim Prokshi